

V E N D I M
Nr. 67, datë 10.1.2003

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PUNËSIMIT DHE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e strategjisë së punësimit dhe të formimit profesional, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano